

TERMAT E REFERENCËS DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE
PËR
“MIRËMBAJTJE E GJELBËRIMIT PËR TRE VITE”

1- Objektivi i këtij shërbimi:

Qëllimi i këtij shërbimi është të realizojë kërkesat e menaxhimit ambjental në Port për të siguruar një ekuilibër ekologjik nga impaktet mjedisore.

Në këtë kuadër, për t'i dhënë portit një pamje më tërheqëse dhe për ta kthyer atë në një hapësirë më të jetueshme, zona të caktuara në port janë gjelbëruar. Përveç gjelbërimit janë përfshirë edhe elemente të arredimit urban siç janë vazot dekorative.

Gjithashtu është e nevojshme që të mirëmbahet dhe përmirësohet investimi i suksesshëm i realizuar vite më parë në Autoritetin Portual.

2- Baza Ligjore

- a. Ligji Nr. 10 431, Datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit“
- b. Ligji Nr. 162, Datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM Nr. 285, Datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

3- Teknologjia e punimeve për mirëmbajtjen

- a. Prerje e barit, pastrim nga barërat e këqija, ndërhyrja totale përfshin çdo lloj pajisjeje, mjeti apo mjeti mekanik të nevojshëm për mbledhjen, ngarkimin, transportin dhe heqjen e materialeve të mbetura.
- b. Prashitje e pemëve, pastrim nga barërat e këqija, pastrim i gjetheve, ndërhyrja totale përfshin çdo lloj pajisjeje, mjeti apo mjeti mekanik të nevojshëm për mbledhjen, ngarkimin, transportin dhe heqjen e materialeve të mbetura.
- c. Krasitje e shkurreve dhe pemëve, me formë të detyruar, ndërhyrja totale përfshin çdo lloj pajisjeje, mjeti apo mjeti mekanik të nevojshëm për mbledhjen, ngarkimin, transportin dhe heqjen e materialeve të mbetura.
- d. Plehërim kimik i barit me nitrat amoni, përfshi furnizimin me pleh kimik si dhe aplikimin e tij me shpërndarje në mënyrë uniforme me karrel dozator ose shpërndarje mekanike.
- e. Plehërim kimik vjetor i pemëve, përfshi furnizimin me plehra kimike si dhe aplikimin e tyre me shpërndarje në mënyrë uniforme me karrel dozator ose shpërndarje mekanike. Për 300 pemët Quercus Ilex e mbjella në port është parashikuar një plehërim vjetor me pleh organik dhe tre plehërim me plehra kimike, nga të cilat një plehërim me NPK në fund të muajit janar, 1 plehërim me ure në muajin qershor dhe një plehërim me nitrat amoni në muajin shtator.
- f. Plehërim kimik dhe organik për të gjitha llojet e bimëve të mbjella në të gjithë territorin e portit. Ky proces duhet të kryhet në muajin dhjetor dhe qershor.
- g. Sipas nevojave duhet të bëhet trajtim me antiparazitarë për të gjitha bimët. Ky proces të kryhet sipas normave të standartit shqiptar për kontrollin e insekteve dhe sëmundjeve parazitare, duke përdorur principe aktive të regjistruara dhe të autorizuar për përdorim të tillë. Për trajtimet me antiparazitarë të bimëve operatori ofertues duhet të zotërojë një pompë spërkatëse.

Prerja e barit dhe pastrimi nga barërat e këqija të kryhet sipas nevojave që paraqet bari, i cili ndryshon në varësi të temperaturave dhe shpejtësisë së rritjes së barit gjatë vitit.

Përdoren dy makina korrëse bari manuale, dy automjete të cilat do shërbejnë për transportimin e makinave korrëse dhe për nxjerrjen e materialeve të mbetura nga korrja e barit, krasitja e pemeve dhe palmave jashtë ambjentëve të portit.

Pastrimi nga barërat e këqija të kryhet në varësi të përhapjes dhe shpejtësisë së rritjes së tyre.

Prashitja e shkurreve dhe bimëve, ndërhyrjet kryhen në bazë të nevojave specifike që paraqesin bimët.

Krasitja e palmave dhe shkurreve me formë, ndërhyrjet të kryhen gjatë gjithë vitit në bazë të nevojave specifike që paraqesin bimët, sipas llojit të bimës.

Mirëmbajtje e vazove dekorative të betonit (si strukturë), krijimi i kushteve për kullimin e ujit, kujdesi për të mos u thyer, pastrimi nga jashtë, etj

Ujitja manuale, në periudhën me temperatura të larta është e nevojshme të kryhet ujitja e bimëve dhe e barit çdo ditë, kurse në periudhën me temperatura të ulta ujitja e barit dhe e bimëve do të kryhet sa herë të jetë e nevojshme.

Ujitja e barit dhe e vazove të ambienteve të jashtme do të sigurohet nga firma kontraktore.

4- Kërkesa të detyrueshme për kontraktorin

- *Për të gjitha shërbimet sa më sipër kërkohet nga kontraktori prezenca me kohë të plotë e dy punëtorëve mirëmbajtjeje me uniformë të kompanisë kontraktore.*
- *Punëtorët duhet të kryejnë kontrollin e të gjitha hapësirave të gjelbërta çdo ditë dhe të njoftojnë investitorin për çdo problem nëse ka.*
- *Sa herë të kryhen proceset për mirëmbajtjen e shërbimit të gjelbërimit si (plehërimi, ujitja, krasitja, spërkatja, kositja, mbjellja e barit, mbjellja e pemëve, etj) kontraktori duhet të njoftojë grupin e monitorimit të kontratës 2 (dy) ditë përpara, në mënyrë që grupi i monitorimit të jetë prezent gjatë kryerjes së procesit.*
- *Të gjitha punimet si (plehërimi, ujitja, krasitja, spërkatja, kostija, mbjellja e barit, mbjellja e pemëve, etj) do të kryhen nga ora 08:00 deri në orën 16:00. Do të ketë përjashtime nga ky orar vetëm në raste të vecanta si psh, probleme emergjente, punë që kanë kohështirje të gjatë ose kur punimet pengojnë orarin zyrtar të punës në port.*
- *Mbjellja e farës së barit dhe e trëndafilave do të bëhet në vitin e parë të kontratës për ato pjesë ku ka nevojë për ndërhyrje. Pjesa që do të mbetet do të mblillet pjesë pjesë sipas nevojave gjatë dy viteve të tjera të kontratës.*

5- Zërat që do të mirëmbahen

A- Sipërfaqet me bar

- Lulishte pranë Drejtorisë Qëndrore (Adem Reka)
- Lulishte përballë me hyrjen 1
- Sipërfaqe e mbjellë me bar pranë hyrjes 2
- Sipërfaqe e mbjellë me bar tek rrethrotullimi i Terminalit të Pasagjerëve dhe trekëndëshat majtas dhe djathtas rrethrotullimit
- Sipërfaqe e mbjellë me bar majtas rrugës së Peshkimit dhe pranë drejtorisë së doganave.

- Sipërfaqe e mbjellë me bar majtas dhe djathtas rrugës nga Terminali i Pasagjerëve deri tek hyrja 4

B- Vazo betoni

- Vazot e mbjella në trotuaret rreth parkimeve.

C- Të ndryshme

- Ambientet pranë Drejtorisë së Mjedisit dhe hyrjes së drejtorisë qendrore.

Bashkëlidhur do të gjeni hartën e portit me sipërfaqet e gjelbërta dhe kodet përkatëse.

NR	ZONA	KODI	SIPËRFAQJA m ²
1	7	709	212
2	7	716	107
3	7	717	64

NR	ZONA	KODI	SIPËRFAQJA m ²
1	18	1816	263
2	18	1828	419

NR	ZONA	KODI	SIPËRFAQJA m ²
1	22	2206	92
2	22	2211	195
3	22	2212	188
4	22	2213	451
5	22	2214	67
6	22	2215	735
7	22	2216	435
8	22	2217	1269
9	22	2221	410
10	22	2223	90
11	22	2238	395

SIPËRFAQJA TOTALE PËR ZONAT E GJELBËRUARA

NR	ZONA	PËRSHKRIMI	KATEGORIA	SIPËRFAQJA m ²
2	7	SIPERFAQE E GJELBËR	GJELBËRIM	383
4	18	SIPERFAQE E GJELBËR	GJELBËRIM	682
5	22	SIPERFAQE E GJELBËR	GJELBËRIM	4327
SIPËRFAQJA TOTALE PËR ZONAT (7 + 18 + 22)				5392

Sipërfaqja përfundimtare është 5392 m².

RELACION SHPJEGUES MBI PUNIMET QË DO TË KRYHEN

1. Mirëmbajtje washingtonia = **6 copë**, 2 tek lulishtja adem reka, 4 tek hyrja 2, sipas preventivit.
2. Mirëmbajtje pemë = **300 copë** Ilex. Pemët janë të shpërndara përgjatë rrugës nga rrethrotullimi i terminalit të trageteve deri, tek rruga e ish peshkimit, tek busti adem rekës dhe tek muri i policisë kufitare, sipas preventivit.
3. Mirëmbajtje ullinj dekorativë dhe palma në vazot cilindrike = **39 copë**, 19 ullinj dhe 20 palma, të shpërndara nëpër trotualet e godinave qendrore të drejtorisë, sipas preventivit. Gjithashtu në fillim të lidhjes së kontratës do të bëhet një mirëmbajtje e vazove të betonit.
4. Mirëmbajtje palma, yucca, jasemin të mbjella në tokë = **38 copë**. Këto bimë janë të mbjella tek oborri përpara Drejtorisë së Mjedisit.
5. Mirëmbajtje e gjelbërimit në hyrje të drejtorisë dhe vazot katrore dhe drejtkëndore = **38 copë**. Shpjegimi në pikën 9 mëposhtë.
6. Mirëmbajtje bari = **5392 m²**, e cila është e shpërndarë në të gjithë territorin e portit.
7. Mirëmbajtje zonë me bar përgjatë rrugës së vjetër për në Kalatën lindore (majtas dhe djathtas) = **1614 m²**. Është e nevojshme të kryhet mirëmbajtje e thjeshtë (pastrim, sistemim i zonës) me qëllim që të mos prishet cilësia vizive e imazhit të krijuar nga zbatimi i projektit të gjelbërimit. Sipërfaqe me kodin 2220 në hartën e portit
8. Përveç shërbimit të mirëmbajtjes do të bëhet rehabilitimi i sipërfaqeve me bar me kodet në hartë si mëposhtë:
2206 – 92 m²
2211 – 195 m²
2212 – 188 m²
2214 – 67 m²
716 – 107 m²
717 – 64 m²
Duhet të rimbillen me bar, pasi të jetë pastruar nga barërat e këqija dhe të jetë kthyer toka.
9. Gjithashtu do të mbillen trëndafila në vazot e betonit para drejtorisë 8 copë, në vazot katrore 7 copë dhe vazot drejtkëndore 23 copë, të vendosura në trotuare dhe rreth parkimeve përpara drejtorisë. Do të mbillen edhe në sipërfaqen poshtë strehës tek hyrja e drejtorisë. Vazot katrore dhe drejtkëndore 30 copë kanë nevojë për ndërrim të dheut dhe pastrim të betonit nga jashtë.

LLOJET E BIMËSISË

1. Palma e ulët tek vazot cilindrike

Chamaerops humilis (Extra Touffe)

Familja:	Arecaceae (Palmë)
Lloji:	Palmë
Lartësia:	80/60/40/20 cm
Rritja:	E ngadaltë
Ekspozimi:	Diell të plotë ose gjysëm hije
Pamja e jashtme:	Gjethet pëllëmbore, gjithmonë e gjelbërt
Ngjyra e lules:	E verdhë
Periudha e çeljes:	Pranverë

Ngjyra e gjethes:	Jeshile
Ngjyra e frutit:	Kafe
Kërkesa për ujë:	Mesatare
Ph i terrenit:	Acid, neutral, alkalinë, lehtësisht alkalinë
Tipi i terrenit:	Ranor, tokë lymore ose humus
Forma:	Palmë me shumë trungje
Menyra e përdorimit:	Vazo
Arsyeja e përzgjedhjes:	Rezistente ndaj kushteve atmosferike, thatësisht, pluhurave, e përshtatshme për klimën e Durrësit, veçanërisht Portit dhe me efekt të lart dekorativ

2. Palmat e larta të mbjella në lulishte

Washingtonia robusta

Familja:	Arecaceae (Washingtonia)
Lloji:	Palmë
Lartësia:	250 cm – 300 cm 300 cm – 350 cm 400 cm – 450 cm
Largësia nga bima në bimë:	600 cm
Rritja:	Mesatare
Ekspozimi:	Diell të plotë ose gjysëm hije
Pamja e jashtme:	Gjithmonë e gjelbër
Ngjyra e lules:	E bardhë
Periudha e çeljes:	Pranverë - Verë
Ngjyra e gjethes:	Jeshile
Ngjyra e frutit:	E zezë
Kërkesa për ujë:	Mesatare
Ph i terrenit:	Acid, neutral, alkalinë, lehtësisht alkalinë
Tipi i terrenit:	Ranor, tokë lymore ose humus
Forma:	Palmë
Menyra e përdorimit:	Pemë dekorative në rrugë, kompozime në grup me lartësi të ndryshme
Arsyeja e përzgjedhjes:	Rezistente ndaj kushteve atmosferike, thatësisht, pluhurave, e përshtatshme për klimën e Durrësit, veçanërisht Portit dhe me efekt të lartë dekorativ

3. Pemët e rrugës nga Terminali i Pasagjerëve deri tek hyrja 4

Ilex quercus

Familja:	Fagaceae
Lloji:	Pemë e lartë
Lartësia:	3.5 m – 4 m
Perimetri i trungut:	20 cm
Pamja e jashtme:	E gjelbër
Ngjyra e gjethes:	Jeshile

Arsyeja e përzgjedhjes: Pemë gjithnjë e gjelbër, karakteristike e klimës dhe peisazhit mesdhetar. Është shumë e përshtatshme për dekorim rrugësh , parqesh, etj. Toleron hijet dhe afërsinë me detit. Rezistente ne temperatura te larta dhe ne temperatura të ulta deri në -15°C

4. Ulli dekorative në vazo cilindrike

Olea europaea

Familja: Oleaceae
Lloji: Pemë
Lartësia: 6-9 m
Ngjyra e lules: E bardhë
Ngjyra e gjethes: Jeshile dhe e bardhë
Pamja e jashtme: Gjethet ovale me ngjyrë të gjelbërt të errët në anën e sipërme ndërsa në anën e poshtme të bardhë në të argjendtë. Në periudhën e lulëzimit zhvillon lule të vogla të bardha në tufa.

5. Lule të mbjella para hyrjes se drejtorise dhe ne vazot katrore dhe drejtkendore

Rosa

Familja: Rosaceae (Rose)
Lloji: Shkurre
Lartësia: 40 cm – 50 cm
Gjerësia: 30 cm – 50 cm
Rritja: Mesatare
Ekspozimi: Diell të plotë
Pamja e jashtme: Gjetherënëse
Ngjyra e lules: E bardhë, e kuqe, e verdhë, portokalli, rozë, lejla, etj
Periudha e çeljes: Pranverë, verë, vjeshtë
Veçori: Lule aromatike, tërheq fluturat
Ngjyra e gjethes: Jeshile
Ngjyra e frutit: Portokalli
Kërkesa për ujë: Mesatare
Ph i terrenit: Acid, neutral, alkaline, lehtësisht alkaline
Tipi i terrenit: Ranor, tokë lymore ose humus
Forma: Shkurre
Menyra e përdorimit: Vazo, bordure
Arsyeja e përzgjedhjes: Rezistente ndaj kushteve atmosferike, thatësisht, pluhurave, e përshtatshme për klimën e Durrësit, veçanërisht Portit dhe me efekt të lartë dekorativ